

03 - 293

27.09.2016



Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova  
Ministry of Internal Affairs

REPUBLIKA E KOSOVËS /  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS  
VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT



Inspektorati Policor i Kosovës  
Policijski Inspektorat Kosova  
Police Inspectorate of Kosovo

*Raporti i Inspektimit Nr: 4 /2016*

## INSPEKTIMI I PERFORMANCËS SË STACIONEVE POLICORE NË DIVIZIONIN E SIGURISË PUBLIKE



*SHTATOR 2016*

**HILMI MEHMETI**  
Kryeshef Ekzekutiv i IPK- së

  


## SHKURTESAT

---

<i>MPB</i>	<i>Ministria e Punëve të Brendshme</i>
<i>IPK</i>	<i>Inspektorati Policor i Kosovës</i>
<i>PK</i>	<i>Policia e Kosovës</i>
<i>DPP</i>	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës</i>
<i>PSO</i>	<i>Procedura Standarde e Operimit</i>
<i>DRP</i>	<i>Drejtoria Rajonale Policore</i>
<i>SIPK</i>	<i>Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës</i>

# PËRMBAJTJA

---

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	(4-5)
2. HYRJE.....	(6-7)
3. PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE.....	(8-23)
3.1. Të vlerësohen detyrat dhe veprimet operacionale në stacionet policore.	
3.2. Vlerësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore	
3.4. Vlerësimi i kapaciteteve teknike dhe kushteve të punës për arritjen e objektivave policore.	
4. PËRFUNDIMET.....	(24-26)
5. REKOMANDIMET.....	(27)
6. PLANI I VEPRIMIT PËR PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE.....	(28-29)

## 1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

---

1.1 Bazuar në Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së ka autorizuar inspektimin e zakonshëm për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave nga ana e punonjësve policorë të të gjitha stacioneve policore nga fusha inspektuese *“Inspektimi i Performancës së Stacioneve Policore në Divizionin e Sigurisë Publike”*. Ky inspektim i funksionalizuar nga Departamenti i Inspektimit të IPK-së, është përqendruar në vlerësimin e kryerjes së detyrave në të gjitha fushat e menaxhimit në kuadër të strukturës së stacioneve policore për periudhën kohore të vitit kalendarik 2015. Ndërsa sa i përket vlerësimit të gjendjes me pajisjet e njërive policore dhe kushtet e mirëmbajtjes së objekteve policore inspektimi përfshinë periudhën kohore gjatë së cilës është kryer inspektimi.

1.2 Marrë në përgjithësi, viti 2015 duke u bazuar në ngjarjet kronologjike të situatës politike nëpër të cilën ka kaluar vendi, numri i madh i ngjarjeve dhe protestave, konsiderohet të ketë qenë njëri ndër vitet me sfida për Policinë e Kosovës. Andaj si rezultat i kësaj gjendje njësitet e stacioneve policore, në numër të konsiderueshëm kanë qenë të angazhuar në aktivitete policore (plane operative) për mbështetje gjatë zhvillimit të këtyre ngjarjeve nëpër të gjitha qytetet e Kosovës. Kjo gjendje e angazhimeve të ngjeshura për stacionet policore ka ndikuar konsiderueshëm në performancën e tyre policore ngase ka ndikuar drejtpërdrejt në reduktimin dhe kufizimin e aktiviteteve planifikuese në kuadër të fushëveprimit dhe zonave të përgjegjësisë së këtyre stacioneve.

1.3 Sipas strukturës organizative të Policisë së Kosovës të datës 20.05.2012, gjatë vitit 2015 në 40 stacione policore janë angazhuar 3298 zyrtarë policor, të shpërndarë nëpër njësitë brenda strukturës së stacioneve policore. Në aspektin demografik, në nivel vendi, del se stacionet policore kanë të angazhuar një (1) polic për 528 banorë. Në aspektin gjeografik-territorial, 3.1 km<sup>2</sup> hapësirë territoriale mbulohet nga (1) një zyrtar policor. Në aspektin e nivelit të krimit ka mesataren e 12 raste të iniciuara për një (1) zyrtar policor.

1.4 Gjatë vitit 2015, në 40 stacione policore janë evidentuar gjithsejtë 163.208 urdhëresa, që në raport me numrin e përgjithshëm prej 3298 zyrtarë zyrtarëve policor në nivel stacionesh rrjedh mesatarisht 50 urdhëresa për polic në nivel vendi. Sa i përket nivelit të zbatimit gjatë vitit 2015, stacionet policore kanë realizuar 62.060 urdhëresa apo 38% të tyre. Ndërsa 62% e urdhëresave tjera të porealizuara barten për vitin vijues apo një numër i tyre i nënshtrohen afateve të parashkrimit. Referuar intervistave dhe takimeve me menaxhmentin policor në nivelin lokal dhe rajonal është potencuar se tek aktiviteti policor për zbatimin e urdhëresave të gjykatave prioritet i jepet lendeve penale të cilat urdhëresa dhe realizohen.

1.5 Gjatë vitit kalendarik 2014/15, nga stacionet policore janë planifikuar 3179 zyrtarë policor për vijueshmërisë në programin trajnimit brenda regjionit, prej tyre 2744 zyrtarë policor apo 86% janë përfshirë në vijimin e këtij trajnimi. Po ashtu nga 40 stacionet policore janë planifikuar 124.720 orë në programin trajnimit brenda regjionit ku prej tyre janë realizuar 87055 apo 70% e tyre. Ndërsa Programin e trajnimit të ricertifikimit gjatë vitit 2015, nga 3009 zyrtarë policor të planifikuar për vijimin e trajnimit të ricertifikimit, trajnimin e kanë kryer 1.625 zyrtarë policorë (54%) e tyre.

1.6 Mirëmbajtja e higjienës nëpër stacionet policore, është vlerësuar të jetë në nivel të mirë. Gjendjen e stacioneve që vlerësohen me nivel të ulët të pastërtisë e pasqyron fakti së objektet policore të këtyre stacioneve janë tejet të vjetruara dhe të cilat objekte nuk i plotësojnë kushtet minimale për punë.

1.7 Sa i përket automjeteve policore, të gjeturat e inspektimit tregojnë se ekziston një gjendje përafërsisht e njëjtë me automjetet e vjetruara dhe gjendjes së rëndë teknike të tyre. Përkundër numrit të konsiderueshëm të automjeteve me të cilat janë të ngarkuara stacionet policore, ka mungesë të konsiderueshme të automjeteve në gjendje të rregullt për qarkullim.

1.8 Nëpër stacione policore nuk aplikohet standardi unik i vendosjes apo menaxhimit të sirtarëve për ruajtjen e armëve zyrtare. Në disa stacione sirtarët gjenden apo menaxhohen nën kujdesin e komandantëve të stacioneve, kurse në disa stacione tjera nëpër zyrat (përgjegjësit) e administratës së stacioneve. Inspektimi fizik i armëve zyrtare nga disa stacione policore kryhet në baza mujore, kurse në disa stacione më rrallë (disa herë brenda vitit). Tek formularët e inspektimit të armëve, është vërejtur se nuk aplikohen formularët standarde në të gjitha stacionet policore.

1.9 Dhomat e dëshmimeve në kuadër të stacioneve policore, marrë parasysh kriteret që kërkohen për të plotësuar standardet e kërkuara me rregullat në fuqi, shumica e stacioneve policore, plotësojnë pjesën dërmuese të standardeve të kërkuara. Kurse në disa stacione nuk kanë të plotësuar një numër të kriterëve të kërkuara.

1.10 Lidhur me menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive të organizatës, të cilat janë dëshmuar me regjistrin e pasurive, në bazë të dokumenteve të rishikuar është gjetur së vetëm në 11 stacione policore me vendim të komandantit të stacionit është formuar komisioni për regjistrimin e pasurisë i cili kryhet për ç' do vit kalendarik. Ndërsa në stacionet tjera policore inspektimi bëhet nga ana e zyrtarëve të Drejtorisë së Logjistikës.

1.11 Mbi të gjeturat e paraqitura në këtë Raport, më 08.09.2016, IPK-ja ka realizuar takim përmbyllës me menaxhmentin e PK-së, fushëveprimi i të cilit lidhet me fushën e inspektuar. Janë diskutuar detajet e raportit dhe më pas palët janë pajtuar me të gjeturat e inspektimit.

## 2. HYRJE

---

2.1 Bazuar në Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së ka autorizuar inspektimin e zakonshëm për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave nga ana e punonjësve policorë të të gjitha stacioneve policore nga fusha inspektuese *“Inspektimi i Performancës së Stacioneve Policore në Divizionin e Sigurisë Publike”*. Inspektimi është përqendruar në vlerësimin e kryerjes së detyrave në të gjitha fushat e menaxhimit. Ky inspektim i funksionalizuar nga Departamenti i Inspektimit të IPK-së është zhvilluar nga data datë 04 mars deri më 15 prill 2016. Inspektimi është përqendruar në të gjitha stacionet policore të Policisë së Kosovës (PK), në përjashtim të atyre në pikat e kalimit kufitar.

2.2 Qëllimi i inspektimit ishte të sigurohemi se disa detyra dhe përgjegjësi në kuadër të fushave të ndryshme menaxheriale zbatohen ashtu siç është paraparë me rregullat në fuqi. Me këtë inspektim synohet që të vlerësohet kryerja e detyrave policore në fushat e menaxhimit policor dhe të jepen rekomandime për përmirësimin e performancës policore në realizimin e qëllimeve në vijim:

- Pajtueshmërinë me dokumentet relevante për punën policore:
  - Ligjin për Policinë,
  - Doracakun “Parimet e Procedurat e Policisë”,
  - Udhëzuesin për Hartimin e Urdhrave/Planeve Operative dhe Menaxhimin e Operacioneve Policore,
  - Rregulloren për Mbrojtjen nga Zjarri,
  - Doracakun Operacional të Njësitit të Trafikut të Policisë,
  - Procedurat Standarde të Operimit për Dhomat e Dëshmime,
  - Udhëzimi Administrativ për Menaxhimin e Pasurive Qeveritare, dhe
  - Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës.
  
- Të inkurajojë menaxhimin profesional policor, të identifikojë dhe përhapë praktikat më të mira policore.

2.3 Rëndësia e këtij inspektimi bazohet në Ligjin për IPK-në, ku inspektimi synon të kontribuojë drejt zhvillimit të politikave të përshtatshme dhe veprimeve konkrete në zbatimin e parimeve dhe proceduarave në aktivitetet ditore. Vlerësimi i performancës menaxheriale të stacioneve policore si njësi bazë e rëndësishme e strukturës policore, përbën një interes të veçantë për IPK-në si mekanizëm mbikëqyrës i efikasitetit dhe efektivitetit të policisë. Detyrat që kanë stacionet, përfshijnë segmentin më të rëndësishëm të policisë. Menaxhimi efikas dhe me përgjegjësi i tyre është i rëndësishëm primare dhe IPK-ja përkujdeset që niveli i efikasitetit të stacioneve policore të vëzhgohet me kujdes.

2.4 Objektivi që do të arrij ky inspektim është:

- Të vlerësohen detyrat dhe veprimet operacionale në stacionet policore.
- Vlerësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore.
- Vlerësimi i kapaciteteve teknike dhe kushteve të punës për arritjen e objektivave policore.

2.5 Periudha mbuluese e kësaj fushë inspektimit përfshinë periudhën prej 01.01.2015-31.12.2015. Ndërsa vlerësimi të gjendjes me pajisjet e njërive policore, dhe kushtet e mirëmbajtjes së objekteve policore inspektimi fokusohet në periudhën kohore gjatë së cilës kryhet inspektimi.

2.6 Si kriter matës Inspektorati Policor i Kosovës ka marrë:

- Ligji i Inspektoratit Policor të Kosovës,
- Ligji i Policisë,
- Ligji mbi Rendin dhe Qetësinë Publike,
- Udhëzuesi për Hartimin e Urdhrave/Planave Operative.
- PSO për Dhomën e Dëshmive.
- UA për Menaxhimin e Pasurisë Qeveritare.
- Doracaku “Parimet dhe Procedurat e Policisë”
- Rregullorja për Mbrojtje nga Zjarri.

2.7 Inspektimi është përqendruar në këto drejtime kryesore:

- Organizimi dhe funksionimi i stacione policore.
- Menaxhimi i burimeve njerëzore.
- Aktivitetet e stacioneve policore.
- Menaxhimi i pasurisë, mjeteve dhe pajisjeve policore.
- Menaxhimi i hetimit, zbulimit të krimit.

2.8 Për finalizimin e këtij inspektimi është përdorur metodologjia e vështrimit mbi dokumente PSO relevante, **Doracaku “Parimet dhe Procedurat e Policisë**, raportet dhe planet vjetore, analizimin dhe intervistimin, vëzhgimin-fotografimin dhe kontrollimin fizik të dokumenteve.

**Vëzhgimi-Fotografimi:** gjatë kohës së inspektimit janë vëzhguar punët e patrullave dhe nga 3 vetura për secilin SP, me qëllim të njoftimit me ngarkesën në detyrë si dhe janë fotografuar të gjitha zyrat dhe hapësirat tjera për t’u vërtetuar lidhur me kushtet e përgjithshme, mjetet e punës etj.

2.9 Gjatë rrjedhës së inspektimit, Inspektorët Policor kanë intervistuar 40 komandant të stacioneve policore dhe 120 zyrtarë policorë; në kuadër të stacioneve policore janë intervistuar 40 shefa të njërive të administratës. Po ashtu stacioneve policore ju është dorëzuar formulari fizik në të cilin janë përcaktuar çështje relevante ku është kërkuar nga ana e personelit përgjegjës të PK-së, ti plotësojnë me të dhëna të cilat ju kanë referuar dokumentacioneve gjegjëse.

### 3. PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE

---

#### 3.1. Vlerësimi i detyrave dhe veprimeve operationale në stacionet policore.

3.1.1. Sipas Ligjit për Policinë, stacionet policore themelohen në secilën komunë, ndërsa juridiksioni territorial i stacionit policor është i njëjtë me kufijtë e Komunës të përcaktuara me ligj<sup>1</sup>. Stacionet policore kryejnë detyra policore në kuadër të juridiksionit të tyre brenda territorit komunal<sup>1</sup>. Për arsye të ndryshme (shtrirjes territoriale, strukturës etnike të popullsisë, nivelit të krimit) në disa komuna janë të themeluara edhe më shumë se një stacion policor, por ka raste kur edhe në kuadër të disa stacioneve policore janë të organizuara edhe nënstationet policore.

3.1.2. Sipas strukturës organizative të Policisë së Kosovës të datës 20.05.2012, stacionet policore, janë të strukturuar nëpër të gjitha Drejtoritë Rajonale Policore në kuadër të Divizionit të Sigurisë Publike. Qëllimi dhe detyrat themelore të stacioneve policore është ofrimi i sigurisë publike dhe forcimi i bashkëpunimit me qytetarë përfshin një sërë objektivash specifike që kanë për qëllim përmbushjen e objektivit strategjik:

- Përmirësimi dhe ruajtja e sigurisë publike, parandalimi dhe zvogëlimi i aktiviteteve kriminale;
- Ngritja e nivelit të sigurisë në komunikacionin rrugor dhe parandalimi i aksidenteve;
- Avancimi i bashkëpunimit dhe vetëdijesimi në partneritet me institucionet dhe komunitetin;
- Ngritja e kapaciteteve operationale dhe profilizimi i njësive<sup>2</sup>.

3.1.3 Duke iu referuar të dhënave mbi nivelin e krimit, nga gjithsejtë 40 stacionet policore të inspektuara për periudhën e vitit 2015 në kuadër të këtyre stacioneve, janë iniciuar gjithsejtë 38846 raste, që në raport me numrin e përgjithshëm prej 3298 zyrtarëve policor të angazhuar në këto stacione policore del mesatarisht 12 raste për një (1) zyrtar policor. Prej 40 stacioneve policore 14 apo 35% e tyre gjatë vitit 2015, kanë pasur mesatare me mbi 12 raste të iniciuara për një zyrtarë policor. Njëmbëdhjetë 11 stacione apo 27.5% gjatë vitit 2015 kanë pasur mesatare prej 8- 12 raste të iniciuara për një zyrtarë policor. Kurse 15 stacione apo 37.5% gjatë vitit 2015, kanë pasur mesatare nën 8 raste të iniciuara për një zyrtarë policor. ( shih tabelën nr. 1).

---

<sup>1</sup> Ligji nr. 04/L-076 Për Policinë/ neni 35 par. 1 dhe 2;

<sup>2</sup> Policia e Kosovës/ Plani zhvillimor strategjik;



Tabela nr. 1. Të dhëna mbi stacionet policore lidhur me Nivelin e rasteve të iniciuara për vitin(2015) <sup>3</sup>		
Kriteri i vlerësimit		
(Mbi 12 raste të iniciuara për polic (gjatë vitit)	(8 deri 12 raste të iniciuara për polic (gjatë vitit)	(Nën 8 raste të iniciuara për polic gjatë vitit)
✓ Pejë	✓ Obiliq	✓ Dragash
✓ Prizren	✓ Drenas	✓ Kllokot
✓ Prishtina Qendra	✓ Istog	✓ Kamenicë
✓ Prishtina Jugu	✓ Viti	✓ Partesh
✓ Prishtina Veri	✓ Kaçanik	✓ Ranilug
✓ Ferizaj	✓ Deçan	✓ Novobërdë
✓ Gjakovë	✓ Klinë	✓ Skenderaj
✓ Suharekë	✓ Rahovec	✓ Leposaviq
✓ Podujevë	✓ Malishevë	✓ Mitrovicë Veri
✓ Lipjan	✓ Shtime	✓ Zveçan
✓ Fushë Kosovë	✓ Vushtrri	✓ Zubin Potok
✓ Graçanicë		✓ Hani Elezit
✓ Gjilan		✓ Shtërpcë
✓ Mitrovica Jugu		✓ Junik
		✓ Mamushë

3.1.4 Një nga fushat ku IPK-ja, ka pasur interesim ishte mënyra e raportimit nga ana e njësive patrulluese në përfundim të orarit të punës (ndërrimit). IPK-ja ka kontrolluar regjistrin e ngjarjeve ditore (radiologun) të mbajtur nga zyrtarët kujdestarë të Dhomës së Radio-Komunikimit. Procedura e raportimit, qoftë gjatë orarit apo edhe pas përfundimit, ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave dhe përcjelljen/dorëzimin e gjendjes për ndërrimin pasues. Pas inspektimit të bërë njësive patrulluese të ndërrimeve kujdestare, IPK-ja ka vlerësuar se në të gjitha njësitë patrulluese kanë kryer raportimin e rregullt në përfundim të orarit të rregullt të punës.

3.1.5 IPK-ja çmon përkushtimin dhe seriozitetin e mbikëqyrësve të njësive patrulluese të stacioneve policore në kryerjen e raportimit të rregullt në përfundim të orarit të punës. Veç kësaj, u sugjerohet zyrtarëve policorë dhe mbikëqyrësve që gjatë përgatitjes së raporteve, t'i kushtojnë rëndësi raportimit sa më detal të ngjarjeve ditore, meqë raportet e tilla në një numër të konsideruar stacionesh nuk ofrojnë pasqyrë të qartë mbi aktivitetet patrulluese.

3.1.6 Për kryerjen e aktiviteteve të ndryshme, shpeshherë policia është e obliguar të përgatisë plane operative. Planet e tilla duhet të përgatiten sipas rregullave standarde në mënyrë që çështjet që planifikohen të përmbajnë elementet përmbajtjesore, dhe që zbatimi i tyre të jetë më efikas. Në kuadër të Policisë është hartuar udhëzuesi që ofron udhëzime për mënyrën e përgatitjes së planeve. Udhëzuesi për Hartimin e Urdhrave/Planeve Operative dhe Menaxhimin e Operacioneve Policore shërben si model për plotësimin e nevojave të hartuesve të tyre. Në fushën e patrullimeve, Parimi P-5.10 (Patrullimi) pika V parasheh që 'eporët e policëve patrullues për situata të veçanta apo të jashtëzakonshme duhet të përgatisin plane detale për drejtimin e trafikut, të cilat duhet të përmbajnë informata mbi hyrje/daljet e lira të automjeteve dhe këmbësoreve, kushtet e punës së policëve të caktuar gjatë periudhës së shërbimit, rrugët alternative për zhvillimin e trafikut pa ndërprerje, kontrollin e përkohshëm të trafikut dhe ndalesat në parkim dhe mundësinë e shfrytëzimit të automjeteve për emergjencë'.

3.1.7 Jo vetëm ky lloj i planeve, por edhe planet tjera kanë qenë objekt inspektimi dhe me këtë rast IPK-ja ka synuar të vlerësojë nivelin e përgatitjes së tyre konform udhëzuesit në

<sup>3</sup> Raportet vjetore të stacioneve policore për 2015;

fuqi. Varësisht prej veçorive dhe specifikave që i përcaktojnë territoret dhe veçorive demografike stacionet policore nxjerrin hartojnë plane operative për përgjigjeje në situata dhe momente të ndryshme<sup>4</sup>.

3.1.8 Pikë më interesim për IPK-në ka qenë edhe hartimet e planeve të reagimit emergjent për objektet e stacioneve policore në rast të krijimit të situatave emergjente. Është obligim i së cilit menaxhment të stacionit që të nxjerrin dokumentet e këtyre planeve. Përveç hartimit dhe nxjerrjes së tyre kopjet fizike të këtyre planeve të reagimit emergjent kanë qenë të vendosura nëpër tabelat e holleve të objekteve policore.

3.1.9 Sipas Parimit P-5.10 (Patrullimi) 'policët që punojnë në patrulla duhet të njoftohen me emrat e kriminelëve dhe kundërvajtësve të supozuar dhe të dinë vendet ku ata sillen zakonisht'. Kjo është e rëndësishme fundamentale duke pasur parasysh se patrulla policore është njësi e parë që vihet në kontakt me qytetarët. IPK-ja ka intervistuar zyrtarët policorë të disa patrullave policore dhe është interesuar lidhur me atë se a janë të pajisura ata gjatë punës në terren me informatat për personat e kërkuar dhe se në çfarë mase listat e tilla janë të freskuara me të dhënat e nevojshme. IPK-ja është njoftuar në stacione se listat e tilla freskohen nga Drejtoritë Rajonale të cilat janë të obliguara t'i bëjnë dhe dorëzojnë ato kohë pas kohe. Po ashtu në sajë të komunikimit zyrtarë PK-ja e ka të inkorporuar listën e personave të kërkuar në kuadër të sistemit elektronik SIPK, dhe në çdo kohë nga tereni patrullat policore mund të kërkojnë verifikimin e së cilit person apo automjet duke thirrur në kujdestaritë në kuadër të stacioneve policore.

3.1.10 Bazuar në nenin 6 të Ligjit për Policinë, 'policia ekzekuton urdhrat dhe udhëzimet e lëshuara në mënyrë të ligjshme nga prokurori publik dhe gjyqtari kompetent'<sup>5</sup>. Një nga format e bashkëpunimit ndërmjet policisë dhe gjykatave është edhe ekzekutimi i urdhëresave të gjykatave nga ana e policisë. Gjykatat marrin vendime të ndryshme gjyqësore, një numër të madh të të cilave obligohet policia t'i ekzekutojë. IPK-ja ka mundësinë që nga numri i përgjithshëm i urdhëresave të pranuar dhe atyre të realizuara të bëjë vlerësimin e efikasitetit të stacionit që bën administrimin e urdhëresave, përfshirë edhe ekzekutimin e tyre. Të dhënat mbi numrin e urdhëresave të pranuar dhe të realizuara, të prezantuara në këtë raport janë siguruar nga Raportet vjetore të stacioneve policore dhe formularit<sup>6</sup> të përpiluar nga IPK.

3.1.11 Sipas këtyre të dhënave gjatë vitit 2015 në 40 stacione policore janë evidentuar gjithsejtë 163.208 urdhëresa. Duke marrë parasysh mesataren e përgjithshme të urdhëresave të pranuar në nivel stacionesh që sillen mesatare prej 50 urdhëresa për polic në nivel vendi. Prej 40 stacioneve policore të inspektuara IPK-ja vlerëson se gjatë vitit kalendarik 2015, 24 stacione policore apo 60% e tyre, niveli urdhëresave të pranuar për ekzekutim vlerësohet si **i lartë** me mbi 25 urdhëresa për një (1) zyrtarë policor. Në 9 stacione policore apo 22.5% e tyre, niveli urdhëresave të pranuar për ekzekutim vlerësohet si **mesatar**, prej 10 deri 25 urdhëresa për një (1) zyrtarë policor. Kurse në 7 stacione policore apo 17.5% të këtyre stacioneve, niveli urdhëresave të pranuar për ekzekutim vlerësohet **i ulët**, me nën 10 urdhëresa për një (1) zyrtarë policor. (shih tabelën nr. 2 ).

<sup>4</sup>Siç është rasti i stacionit policor në Malisheve gjatë sezonës së verës rreziku i rriqrave etj

<sup>5</sup> Ligji Nr. 04/L-076 Për Policinë;

<sup>6</sup> Dokument fizik i përpiluar nga DI, i cili është plotësuar me të dhënat e kërkuara nga punonjësit policor.

Tabela nr. 2. Të dhëna mbi stacionet policore lidhur me numrin e urdhëresave të pranuar për vitin(2015) <sup>7</sup>		
Kriteri i vlerësimit		
I Lartë (Mbi 25 urdhëresa të pranuar për polic gjatë vitit)	Mesatar (10-25 urdhëresa të pranuar për polic gjatë vitit)	I Ulët (Nën 10 urdhëresa të pranuar për polic gjatë vitit)
<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Prizren</li> <li>✓ Prishtinë Qendra</li> <li>✓ Prishtinë Veri</li> <li>✓ Prishtinë Jugu</li> <li>✓ Drenas</li> <li>✓ Dragash</li> <li>✓ Suharekë</li> <li>✓ Podujevë</li> <li>✓ Mamush</li> <li>✓ Lipjan</li> <li>✓ Gjilan</li> <li>✓ Viti</li> <li>✓ Kamenicë,</li> <li>✓ Vushtrri</li> <li>✓ Mitrovica Veri</li> <li>✓ Ferizaj</li> <li>✓ Kaçanik</li> <li>✓ Pejë</li> <li>✓ Kline</li> <li>✓ Istog</li> <li>✓ Deçan</li> <li>✓ Gjakovë</li> <li>✓ Malishevë</li> <li>✓ Rahovec</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Mitrovica Jugu</li> <li>✓ Skenderaj</li> <li>✓ Graçanica</li> <li>✓ Fushë Kosovë</li> <li>✓ Obiliq</li> <li>✓ Klokot,</li> <li>✓ Novobërdë</li> <li>✓ Hani i Elezit</li> <li>✓ Shtimje</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Partesh</li> <li>✓ Ranilug</li> <li>✓ Lepsaviq</li> <li>✓ Zveçan</li> <li>✓ ZubinPotok</li> <li>✓ Shtërpçë</li> <li>✓ Junik</li> </ul>

3.1.12 Ndërsa sa i përket nivelit të zbatimit gjatë vitit 2015, zyrtarët policorë të 40 stacioneve nga gjithsejtë 163.208 urdhëresa, kanë realizuar 62.060 urdhëresa apo 38% të tyre. Prej 40 stacioneve policore të inspektuara IPK-ja vlerëson se gjatë vitit kalendarik 2015, 6 stacione policore apo 15% e tyre, niveli realizimit të urdhëresave të gjykatave, vlerësohet si **i lartë** me mbi 70% urdhëresa të realizuara<sup>8</sup>. Në 14 stacione policore apo 35% e tyre, niveli realizimit të urdhëresave të gjykatave, vlerësohet si **mesatar**, me 50 deri 70% urdhëresa të realizuara. Kurse në 20 stacione policore apo 50% të tyre, niveli realizimit të urdhëresave të gjykatave vlerësohet **i ulët**, me nën 50% të urdhëresave të realizuara për një (1) zyrtarë policor. Bazuar nga intervistat me zyrtarët policor nëpër stacionet policore, tek aktiviteti policor për zbatimin e urdhëresave të gjykatave prioritet i jepet lëndëve penale të cilat urdhëresa zakonisht realizohen. (shih tabelën nr. 3).

<sup>7</sup> Të dhënat e siguruar nga raportet vjetore 2015 të stacioneve policore dhe formulari IPK;

<sup>8</sup> VEREJTJE; Stacionet policore në kuadër të DRP-Mitrovicë e Veriut për arsye të njohura dhe mosfunksionimit të sistemit gjyqësor të asaj ane kanë numër të ulët të urdhëresave të pranuar për ekzekutim.

Tabela nr. 3. Të dhëna mbi stacionet policore lidhur me realizimin e urdhëresave të gjykatave për vitin(2015) <sup>2</sup>		
Kriteri i vlerësimit		
I lartë (Mbi 70% urdhëresa të ekzekutuara në nivelin e stacionit policore gjatë vitit)	Mesatar (50- 70 % urdhëresa të ekzekutuara në nivelin e stacionit policore gjatë vitit)	I ulët (Nën 50% urdhëresa të ekzekutuara në nivelin e stacionit policore gjatë vitit)
<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Partesh</li> <li>✓ Mitrovica Veri</li> <li>✓ Leposaviq</li> <li>✓ Zveçan</li> <li>✓ Zubin Potok</li> <li>✓ Pejë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Dragash</li> <li>✓ Prizren</li> <li>✓ Mamushë</li> <li>✓ Suharekë</li> <li>✓ Podujevë</li> <li>✓ Graçanicë</li> <li>✓ Kamenicë</li> <li>✓ Klllokot</li> <li>✓ Ranilug</li> <li>✓ Novobërdë</li> <li>✓ Hani Elezit</li> <li>✓ Shtërpçë</li> <li>✓ Istog</li> <li>✓ Junik</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Drenas</li> <li>✓ Lipjan</li> <li>✓ Prishtinë Jugu</li> <li>✓ Prishtinë Qendra</li> <li>✓ Prishtinë Veri</li> <li>✓ Fushë Kosovë</li> <li>✓ Gjilan</li> <li>✓ Viti</li> <li>✓ Mitrovica Jugu</li> <li>✓ Skenderaj</li> <li>✓ Vushtri</li> <li>✓ Ferizaj</li> <li>✓ Kaçanik</li> <li>✓ Shtime</li> <li>✓ Deçan</li> <li>✓ Klinë</li> <li>✓ Gjakovë</li> <li>✓ Rahovec</li> <li>✓ Malishevë</li> <li>✓ Obiliq</li> </ul>

3.1.13 Në të gjitha stacionet policore janë caktuar zyrtarët përkatës në kuadër të njësive të hetimeve të cilët merren dhe trajtojnë me prioritet rastet e dhunës në familje. Gjatë inspektimit, inspektorëve ju është prezantuar qoftë vendimet apo edhe certifikatat e trajnimeve për zyrtarët policore të caktuar në këto detyra policore. Këta zyrtarë janë hetues në kuadër të Njësive të Hetimeve në Stacionet Policore përkatëse.

3.1.14 Sipas Parimit P-4.11 (Arrestimi i përkohshëm dhe ndalimi policor) “përcaktohen të drejtat që gëzojnë personat e arrestuar apo të ndaluar dhe obligimin e policisë për respektimin e këtyre të drejtave”. Disa nga të drejtat që i potencon parimi përfshijnë: të drejtën e njoftimit për arsyet e arrestimit në gjuhën të cilën ai e kupton, të drejtën për të heshtur dhe të mos përgjigjet asnjë pyetjeje përpos me rastin e dhënies së shënimeve mbi identitetin, të drejtën për kontrollim dhe tretman mjekësor, të drejtën në ndihmën e mbrojtësit, të drejtën për njoftimin e familjes apo të personave të tjerë”. Pas intervistave të zhvilluara me 120 zyrtarë policorë të rastit që janë gjendur në stacion, inspektorët policorë kanë konstatuar se zyrtarët e intervistuar policorë të 40 stacioneve të inspektuara kishin njohuri të konsiderueshme për të drejtat e personave të arrestuar apo ndaluar si dhe për procedurat e trajtimit të personave të arrestuar. Zyrtarët e intervistuar policorë të disa stacioneve të inspektuara kanë paraqitur disa shqetësime lidhur me realizimin e të drejtave të këtyre personave. Vështirësi e paraqitur në rastet me të shpeshta të disa stacioneve policore është sigurimi i përkthyesit, në rastet kur subjekt i arrestimit janë personat me shtetësi të huaj si dhe komunikimi me persona me nevoja të veçanta (shurdhmemecet).

### 3.2. Vlerësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore

3.2.1 Në bazë të strukturës organizative të Policisë së Kosovës të datës 20.05.2012, shpërndarja e personelit policor nëpër stacione dhe nënstacione policore është përcaktuar duke u mbështetur në kriteret dhe parametra të caktuar (qoftë sipas zonës gjeografike, nivelit të krimit, numrit të popullsisë apo edhe ndonjë parametri tjetër). Varësisht nga specifikat që karakterizojnë zonat gjeografike si ato urbane dhe rurale është bërë

kategorizimi i stacioneve policore në tri kategori A,B,C si dhe kategoria e nën-stacioneve policore. Hartimit dhe funksionalizimit të kësaj strukture organizative të PK-së i ka paraprirë raporti i Ekspertit të TAIEX<sup>9</sup>. Bazuar në këtë vlerësim të këtij raporti stacionet policore janë ndarë në këto kategori:

- Nëntë (9) stacione policore me statusin e kategorisë "A"
- Nëntëmbëdhjetë (19) stacione policore me statusin e kategorisë "B"
- Dymbëdhjetë (12) stacione policore me statusin e kategorisë "C" dhe
- Njëzetë e dy (22) stacione policore me statusin e nën-stacioneve.<sup>10</sup>

3.2.2 Duke zhvilluar aktivitetin e tyre në kuadër të Drejtorive Rajonale Policore, stacionet policore kanë të definuar zonën e përgjegjësisë brenda kufijve territorial komunal. Bazuar në të dhënat e Stacioneve Policore, duke përfshirë edhe nënstacionet policore kanë të angazhuar 3.298 zyrtarë policorë të uniformuar. Lidhur me të dhënat demografike dhe gjeografike, IPK-ja është shërbyer me të dhënat e siguruar nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës dhe Raporteteve të stacioneve policore. Në bazë të regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 sipas ASK-së, Kosova ka 1,739,825 banorë<sup>11</sup>. Në aspektin demografik, duke vënë në raport numrin e zyrtarëve policorë të stacioneve me numrin e banorëve të territorit të kontrolluar, del se stacionet policore kanë të angazhuar afërsisht një (1) polic për 528 banorë, kurse në aspektin gjeografik-territorial, i bie afërsisht 3.1 km<sup>2</sup> hapësirë territoriale mbulohet nga 1 policë.

3.2.3 Të dhënat demografike nga raportet e stacioneve policore në raport polic banor kemi një shifër tjetër, ku sipas këtyre të dhënave del se të gjitha stacionet kujdesen për 2.353.654 banor dhe duke vënë në raport numrin e zyrtarëve policorë të stacioneve me numrin e banorëve sipas stacioneve për territorin e kontrolluar, del se stacionet policore kanë të angazhuar afërsisht një (1) polic për 714 banorë. Kjo bazohet në atë se personeli i angazhuar ndryshon dukshëm nga stacioni në stacion. Derisa në Leposaviq, një polic angazhohet në 174 banorë të kësaj komune, në Podujevë, një polic angazhohet në 1065 banorë, Prishtina ka ngarkesë për një (1) polic mbi një mijë banorë, afërsisht edhe Peja kanë të njëjtën ngarkesë ku 1 (një) zyrtar policor ka në mbikëqyrje rreth 1000 banor. Rasti tjetër, derisa 1 (një) zyrtar policor i Stacionit të Fushë Kosovës, mbulon 0.8-2 km<sup>2</sup> të këtij lokaliteti, në anën tjetër, 1 (një) zyrtar policor i stacionit të Podujevës mbulon 7.6 km<sup>2</sup> të territorit.

3.2.4 Policia është e përkushtuar që të sigurojë trajnime të përshtatshme që do të plotësonin kushtet operacionale e administrative, si dhe nevojat për avancim profesional të personelit. Lidhur me trajnimin regjional, Parimi P-8.15 i Doracakut 'Parimet dhe Procedurat e Policisë' parasheh që zyrtarët policorë nën komandën e drejtorëve rajonalë, brenda regjionit duhet të mbajnë së paku 40 orë trajnim gjatë vitit. Pas identifikimit të nevojave për trajnime, deri në fund të muajit mars dorëzohen në nivel qendror kërkesat për aprovim të planeve për trajnimet e brendshme në kuadër të regjioneve. Programi trajnues fillon të realizohet nga fillimi i korrikut deri në fund të qershorit të vitit pasues. E interesuar për shkallën e vijueshmërisë së zyrtarëve policorë në Programin trajnues, IPK-ja ka siguruar të dhënat e nevojshme nga zyrtarët e burimeve njerëzore në kuadër të stacioneve policore.

3.2.5 Sa i përket përfshirjes së vijueshmërisë së zyrtarëve policore në programin e trajnimeve të brendshme brenda DRP-ve, prej 40 stacioneve policore të inspektuara IPK-ja

<sup>9</sup>TAIEX- Technical Assistance and Information Exchange instrument of the European Commission;

<sup>10</sup> Raporti Final I Misionit nga 12 mars deri 13 prill 2012 /Nga Eksperti i TAIEX Joseph Delaney MBA BSc. Ref. 16315

<sup>11</sup> Agjencioni i Statistikave të Kosovës/Regjistrimi i popullsisë së vitit 2011 Ëeb -faqe;

vlerëson se gjatë vitit kalendarik 2014/15, 30 stacione policore apo 80% e tyre, niveli vijueshmërisë në trajnimin e zyrtarëve policorë brenda regjionit vlerësohet **i lartë** me mbi 85%. Në 4 stacione policore apo 10% e tyre, niveli vijueshmërisë në trajnimin e zyrtarëve policorë në trajnimet brenda regjionit vlerësohet **si mesatar** me 75-85% të vijueshmërisë së zyrtarëve policorë në trajnimet brenda regjionit. Kurse në 6 stacione policore apo 10% të këtyre stacioneve, niveli vijueshmërisë në trajnimin e zyrtarëve policorë , vlerësohet **i ulët** me nën 70%. ( shih tabelën nr. 4).

3.2.6 IPK-ja nuk është e kënaqur më nivelin e vijueshmërisë së trajnimeve regjionale nga zyrtarët policorë të stacioneve të cilat kanë arritur nivel të vijueshmërisë së trajnimeve nën 70%, më shpresë së menaxheret e këtyre stacioneve në të ardhmen do të bëjnë përpjekje maksimale me qëllim të ngritjes së normës së realizimit të programit të trajnimeve të brendshme. Në anën tjetër, IPK-ja inkurajon dhe çmon përkushtimin dhe seriozitetin e menaxhmenteve policore të stacioneve për respektimin në masë të konsiderueshme të Parimit P-8.15, duke siguruar nivel të vijueshmërisë mbi 85% në programin e trajnimeve të brendshme brenda DRP-ve.

Tabela nr. 4. Të dhënat mbi stacionet lidhur me vijueshmërinë e zyrtarëve policorë në trajnimet brenda Regjionit (për vitin 2015) <sup>12</sup>		
Kriteri i vlerësimit		
I Lartë (mbi 85%)	I Kënaqshëm (75-85%)	I Ulët (nën 70%)
✓ Dragash	✓ Lipjan	✓ Gjilan
✓ Rahovec	✓ Vushtrri	✓ Mitrovica Jugu
✓ Prizren	✓ Pejë	✓ Shtime
✓ Mamush	✓ Klinë	✓ Gjakovë
✓ Suharekë		✓ Kaçanik
✓ Podujevë		✓ Graçanic
✓ Obiliq		
✓ Drenas		
✓ Prishtinë Jugu		
✓ Prishtinë Qendra		
✓ Prishtinë Veri		
✓ Fushë Kosovë		
✓ Ranilug		
✓ Kamenicë		
✓ Kllokot		
✓ Viti		
✓ Partesh		
✓ Novobërdë		
✓ Skenderaj		
✓ Leposaviq		
✓ Mitrovica Veri		
✓ Zveqan		
✓ Ferizaj		
✓ Hani Elezit.		
✓ Shtërpçë,		
✓ Istog,		
✓ Deçan,		
✓ Junik,		
✓ Malishevë		
✓ Zubin Potok		

3.2.7 Lidhur me përmbushjen e orëve të planifikuara, për realizimin e programit të trajnimeve të brendshme brenda DRP-ve, prej 40 stacioneve policore të inspektuara IPK-ja vlerëson se gjatë vitit kalendarik 2015, 14 stacione policore apo 40% e tyre, niveli realizimit

<sup>12</sup> Të dhënat e mbledhura nga stacionet policore gjatë inspektimit/Përgjigje në formularin e detyrave nga IPK-ja;

të orëve të planifikuara për trajnimin e zyrtarëve policor, vlerësohet **i lartë** me mbi 85%. Në 6 stacione policore apo 10% e tyre, niveli realizimit të orëve të planifikuara, vlerësohet **mesatar**, me 75-85%. Kurse në 20 stacione policore apo 50% të këtyre stacioneve, niveli realizimit të orëve të planifikuara, vlerësohet **i ulët** me nën 75%. (shih tabelën nr. 5).

Tabela nr. 5. Të dhënat mbi stacionet lidhur me përmbushjen e orëve të trajnimit brenda regjionit (për vitin 2015) <sup>5</sup>		
Kriteri i vlerësimit		
I Lartë (mbi 85%)	I Kënaqshëm (75-85%)	I Ulët (nën 70%)
<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Dragash</li> <li>✓ Rahovec</li> <li>✓ Prizren</li> <li>✓ Suharekë</li> <li>✓ Podujevë</li> <li>✓ Obiliq</li> <li>✓ Ranilug</li> <li>✓ Kamenicë</li> <li>✓ Leposaviq</li> <li>✓ Ferizaj</li> <li>✓ Shtërpçë</li> <li>✓ Klinë</li> <li>✓ Malishevë</li> <li>✓ Zubin Potok</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Mamushë</li> <li>✓ Partesh</li> <li>✓ Vushtrri</li> <li>✓ Junik</li> <li>✓ Drenas</li> <li>✓ Graçanicë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Prishtinë Jugu</li> <li>✓ Prishtinë Qendra</li> <li>✓ Prishtinë Veri</li> <li>✓ Fushë Kosova</li> <li>✓ Lipjan</li> <li>✓ Gjilan</li> <li>✓ Kllokot</li> <li>✓ Viti</li> <li>✓ Novobërdë</li> <li>✓ Mitrovica Jugu</li> <li>✓ Skenderaj</li> <li>✓ Mitrovica Veri</li> <li>✓ Zveçan</li> <li>✓ Shtime</li> <li>✓ Kaçanik</li> <li>✓ Pejë</li> <li>✓ Istog</li> <li>✓ Deçan</li> <li>✓ Gjakovë</li> <li>✓ Hani Elezit</li> </ul>

3.2.8 Sipas Parimit P-8.14 (Trajnimi për ricertifikim) 'të gjithë policët janë të obliguar që çdo 10-14 muaj të vijojnë trajnimin e ricertifikimit. IPK-ja ka siguruar nga menaxhmentet e stacioneve të dhëna mbi numrin e të ricertifikuarve për periudhën 2015. Të dhënat dëshmojnë që gjatë vitit 2015, nga 3009 zyrtarë policor të planifikuar për vijimin e trajnimit të ricertifikimit, trajnimin e kanë kryer 1.625 zyrtarë policorë (54%), Prej 40 stacioneve policore të inspektuara IPK-ja vlerëson se gjatë vitit kalendarik 2015, 12 stacione policore apo 35% e tyre, niveli vijueshmërisë në trajnimin e ricertifikimit vlerësohet **i lartë** me mbi 70%. Në 17 stacione policore apo 35.5% e tyre, niveli vijueshmërisë në trajnimin e ricertifikimit vlerësohet si **mesatar**, me 40 deri 70%. Kurse në 11 stacione policore apo 27.5% të tyre, niveli vijueshmërisë në trajnimin e ricertifikimit vlerësohet **i ulët**, me nën 40%. ( Shih tabelën nr. 6).

3.2.9 IPK-ja përgjithësisht është ndarë e pakënaqur me nivelin e ricertifikimit në shkallë vendi. Sipas të dhënave, një numër stacionesh fare pak janë kyçur në procesin e ricertifikimit, kurse një numër i konsiderueshëm stacionesh nuk kanë arritur as për së afërmi nivelin e nevojshëm të të ricertifikuarve. Marrë parasysh mesataren e përgjithshme të të ricertifikuarve në nivel stacionesh, IPK-ja e vlerëson të papranueshëm nivelin e të ricertifikuarve nga stacionet policore nën 40%. Në anën tjetër, IPK inkurajon dhe çmon përkushtimin dhe seriozitetin e menaxhmenteve të stacioneve për respektimin e Parimit P-8.14 lidhur me trajnimin e ricertifikimit të zyrtarëve policorë, duke arritur nivelin mbi 70%.

Tabela nr. 6. Të dhënat e stacioneve policore lidhur me nivelin e të ricertifikuarve për Vitin 2015 <sup>13</sup>		
Kriteri i vlerësimit		
I lartë (Mbi 70%)	Mesatar (40-70%)	I ulët (Nën 40%)
<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Mamushë</li> <li>✓ Obiliq</li> <li>✓ Drenas</li> <li>✓ Prishtinë Jugu</li> <li>✓ Prishtinë Qendra</li> <li>✓ Kllokot</li> <li>✓ Kamenicë</li> <li>✓ Partesh</li> <li>✓ Mitrovica Jugu</li> <li>✓ Skenderaj</li> <li>✓ Vushtrri</li> <li>✓ Shtime</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Podujevë</li> <li>✓ Fushë Kosovë</li> <li>✓ Graçanicë</li> <li>✓ Gjilan</li> <li>✓ Viti</li> <li>✓ Hani Elezit</li> <li>✓ Shtërpçë</li> <li>✓ Pejë</li> <li>✓ Klinë</li> <li>✓ Deçan</li> <li>✓ Junik</li> <li>✓ Gjakovë</li> <li>✓ Rahovec</li> <li>✓ Istog</li> <li>✓ Lipjan</li> <li>✓ Prishtinë Veri</li> <li>✓ Ferizaj,</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Prizren</li> <li>✓ Dragash</li> <li>✓ Malishevë</li> <li>✓ Suharekë</li> <li>✓ Ranilug</li> <li>✓ Novobërdë</li> <li>✓ Leposaviq</li> <li>✓ Mitrovica Veri</li> <li>✓ Zveçan</li> <li>✓ Zubin Potok</li> <li>✓ Kaçanik</li> </ul>

3.2.10 Përmes krahasimit të të dhënave mbi shfrytëzimin e pushimeve mjekësore, IPK-ja synon të vlerësojë realisht nivelin e motivimit të zyrtarëve për punë dhe nivelin e mbikëqyrjes së shfrytëzimit të pushimeve nga ana e mbikëqyrësve. Për të vlerësuar nivelin e shfrytëzimit të pushimeve mjekësore, IPK-ja është shërbyer me të dhënat e stacioneve, për besueshmërinë e të cilave mbajnë përgjegjësinë e plotë ato. IPK-ja nuk është kundër asaj që zyrtarët të mos i gëzojnë të drejtat e tyre të cilat janë të garantuara me legjislacion, por është për eliminimin e mundësive që në emër të pushimeve mjekësore të shfrytëzohen ditët e punës duke humbur një numër të madh të tyre. Duhet që menaxhmentet të rrisin motivimin për punë të suksesshme por edhe që të angazhohen për një menaxhim më të duhur të pushimeve mjekësore. Në përgjithësi shfrytëzimi i pushimeve mjekësore, në bazë të të dhënave nga Stacionet Policore nuk ka paraqitur pengese në kryerjen e detyrave policore.

3.2.11 Të dhënat tabelore të paraqitura në tabelën nr 7, në vitin 2015 dëshmojnë për gjithsej 27.931 ditë të humbura si ditë të pushimeve mjekësore, të shfrytëzuara nga personeli policor i stacioneve gjatë një viti (mesatarisht 8 ditë për polic në vit). Prej 40 stacioneve policore të inspektuara IPK-ja vlerëson se gjatë vitit kalendarik 2015, në 4 stacione policore apo 10% e tyre, niveli shfrytëzimit të ditëve të pushimeve mjekësore vlerësohet si **i ulët** me mesatare nën 5 ditë pushimi të shfrytëzuara për një (1) zyrtarë policor. Në 16 stacione policore apo 40% e tyre, niveli shfrytëzimit të ditëve të pushimeve mjekësore vlerësohet si **mesatar**, me 5-7 ditë pushimi të shfrytëzuara për një (1) zyrtarë policor. Kurse në 20 stacione policore apo 50% të këtyre stacioneve, niveli shfrytëzimit të ditëve të pushimeve mjekësore vlerësohet si **i lartë**, me mbi 7 ditë pushimi të shfrytëzuara për një (1) zyrtarë policor. IPK-ja e vlerëson në përgjithësi të mirë nivelin momental të shfrytëzimit të pushimeve mjekësore nga zyrtarët policorë të stacioneve të cilat kanë arritur nivel të shfrytëzimit të pushimeve mjekësore afërsisht nën dhjetë (10) ditë për polic gjatë vitit. Në anën tjetër, IPK-ja inkurajon dhe çmon përkushtimin dhe seriozitetin e menaxhmenteve të stacioneve për menaxhimin e duhur të shfrytëzimit të pushimeve mjekësore, duke arritur nivelin nën pesë (5) ditë të shfrytëzuar për polic në vit. ( shih tabelën nr. 7).

<sup>13</sup>Të dhënat e mbledhura nga stacionet policore gjatë inspektimit/Përgjigje në formularin e detyrave nga IPK-ja;



Tabela nr. 7. Të dhënat mbi stacionet lidhur me shfrytëzimin e pushimeve mjekësore (për vitin 2015)		
Kriteri i vlerësimit		
I Ulët (nën 5 ditë në vit)	Mesatar (5-7 ditë në vit)	I Lartë (mbi 7 ditë në vit)
<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Gjilan</li> <li>✓ Partesh</li> <li>✓ Rahovec</li> <li>✓ Malishevë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Prishtinë Qendra</li> <li>✓ Podujevë</li> <li>✓ Dragash</li> <li>✓ Prizren</li> <li>✓ Obiliq</li> <li>✓ Kamenicë</li> <li>✓ Novobërdë</li> <li>✓ Ranilug</li> <li>✓ Skenderaj</li> <li>✓ Vushtrri</li> <li>✓ Shtime</li> <li>✓ Hani Elezit</li> <li>✓ Istog</li> <li>✓ Deçan</li> <li>✓ Junik</li> <li>✓ Zubin Potok</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Mamushë</li> <li>✓ Suharekë</li> <li>✓ Drenas</li> <li>✓ Prishtinë Jugu</li> <li>✓ Prishtinë Veri</li> <li>✓ Lipjan</li> <li>✓ Fushë Kosovë</li> <li>✓ Graçanicë</li> <li>✓ Kllokot</li> <li>✓ Viti</li> <li>✓ Mitrovica Jugu</li> <li>✓ Leposaviq</li> <li>✓ Mitrovica Veri</li> <li>✓ Zveçan</li> <li>✓ Ferizaj</li> <li>✓ Kaçanik</li> <li>✓ Shtërpcë</li> <li>✓ Pejë</li> <li>✓ Klinë</li> <li>✓ Gjakovë</li> </ul>

3.2.12 Në vazhden e zhvillimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore, policia përgatit kuadro të reja sipas një programi të caktuar, duke u ofruar policëve të rinj një trajnim themelor disa mujor që ka për qëllim ngritjen e njohurive të tyre në fusha të caktuara. Pas përfundimit të kësaj faze trajnuese, ata shpërndahen nëpër stacione, duke iu nënshtruar një fazë të re të përgatitjes, gjatë së cilës do të mundohen që njohuritë që i kanë zënë gjatë trajnimit themelor, t'i praktikojnë gjatë trajnimit në terren. Gjatë këtij programi, kadetët marrin njohuri praktike nga fusha e patrullimeve, trafikut, hetimeve dhe fusha tjera me rëndësi, nën mbikëqyrjen e oficerëve të trajnimit në terren. Sipas Parimit P-8.11, 'Policia duhet të zhvillojë një Program Trajnimi Policor në Terren që ka për qëllim zhvillimin e mëtutjeshëm të standardeve profesionale të një udhëheqjeje demokratike'. Në përfundim të këtij programi trajnues në tërësi duhet të bëhet një raport vlerësues i përgjithshëm që do të përmbajë një përfundim për atë se a është kandidati i aftë për punë policore apo jo.

3.2.13 Për të vlerësuar përmbushjen e këtij obligimi që del për menaxhmentet policore të stacioneve, IPK-ja duke kontrolluar dosjet e një numri kandidatësh të gjeneratave të fundit që janë caktuar me detyrë në stacione, ka ardhur në përfundim se kandidatëve që janë marrë si mostër inspektimi iu është bërë vlerësimi i përgjithshëm nga ana e mbikëqyrësve të stacioneve. IPK-ja çmon përkushtimin dhe seriozitetin e menaxhmenteve të stacioneve policore për respektimin e Parimit P-8.11, lidhur me vlerësimin e përgjithshëm të kandidatëve në përfundim të programit të trajnimit në terren.

3.2.14 Meqë kontrolli është një nga elementet bazë të menaxhimit, puna e çdo zyrtari mbikëqyrës nga menaxhmenti. Zyrtarët policorë që luajnë rolin e mbikëqyrësve janë të obliguar që të bëjnë vlerësimin e punës së vartësve të tyre. Lidhur me këtë, neni 55 i Ligjit për Policinë potencon se 'policia së paku një herë në vit vlerëson punën e zyrtarit policor për të përcaktuar efikasitetin e punës së tij/saj në përmbushjen e kërkesave të shërbimit dhe të standardeve të domosdoshme profesionale gjatë kryerjes së detyrave policore'. IPK-ja ka kontrolluar në çdo stacion një numër të caktuar dosjesh, gjithsej 120 dosje të punonjësve, dhe ka vërejtur se të gjithë punonjësve policorë që janë marrë si mostër inspektimi iu është bërë vlerësimi i performancës policore nga ana e mbikëqyrësve të stacioneve.

### 3.3. Vlerësimi i kapaciteteve teknike dhe kushteve të punës për arritjen e objektivave policore.

3.3.1 Përveç nevojës së vazhdueshme për mirëmbajtje higjienike dhe fizike materiale, ndërtesat policore kanë nevojë të iu nënshtrohen ndërmarrjes së disa masave parandaluese për largimin e rrezikut nga zjarret, vërshimet apo fatkeqësitë tjera. Sipas Rregullores për Mbrojtje nga Zjarri, ndërtesat duhet të jenë të pajisura me pajisje të caktuara për t'u mbrojtur nga ndonjë zjarr i mundshëm. Pajisja e objekteve policore me aparate kundër zjarrit shtron nevojën për përgatitjen e personelit në përdorimin e tyre. Po ashtu, 'të punësuarit në të gjitha objektet policore duhet të jenë të njoftuar për masat preventive themelore nga aspekti i mënyrës së përdorimit të aparateve për shuarjen e zjarrit me mjete që gjenden në objekt'.

3.3.2 Gjatë inspektimit objektet e stacioneve policore kanë qenë të pajisura me aparate të mjaftueshme për fikjen e zjarrit. Po ashtu është bërë kontrollimi i aparateve për testimet dhe afatet e testeve të tyre nga ana e Agjencionit për Menaxhimin e Emergjencave. Pajisja e objekteve policore me aparate kundër zjarrit shtron nevojën për përgatitjen e personelit në përdorimin e tyre dhe gjetjen e një mundësie më të përshtatshme për këtë qëllim (trajnim, demonstrim, bisedë etj). Ekipi i IPK-së gjatë punës në teren është interesuar edhe për pajisjen e sistemit të detektimit të tymit, sisteme të cilat janë të instaluar nëpër objektet policore por nuk është arritur të konfirmohet nga menaxhmenti apo personeli kompetent, se këto pajisje janë testuar ndonjëherë për gjendjen teknike gjatë vitit 2015. Alarmet e sigurisë nëpër stacionet policore janë të vendosura në hapësirat që konsiderohen të ndjeshme si dhomat e dëshmimeve dhe qendrat e mbajtjes.

3.3.3 Zyrtarët policorë përveç që janë të autorizuar dhe kompetent në mbrojtjen e rendit dhe ligjit në drejtim të ofrimit të sigurisë për qytetarët, ata janë të obliguar të respektojnë edhe rregullat e sjelljes të parapara me ligj. Një nga këto rregulla që paraqet edhe kufizime për policinë, është të respektohet e ndalesës për pirjen e duhanit në automjete dhe ndërtesa policore. Inspektorët policorë kanë inspektuar ndërtesat policore për të vlerësuar se sa respektohet ndalesa për pirjen e duhanit. Ata kanë kontrolluar hapësirat e veçanta për pirjen e duhanit, kanë verifikuar vendosjen e mbishkrimeve në hapësirat e brendshme me të cilat publikohet ndalesa për pirjen e duhanit. Në bazë të të gjeturave, IPK-ja vlerëson se në kuadër të stacioneve policore respektohet plotësisht ndalesa për pirjen e duhanit.

3.3.4 Sa i përket aspektit të mirëmbajtjes higjienës nëpër stacionet policore gjendja është vlerësuar të jetë në nivel të konsiderueshëm e mirë. Kur kihet parasysh fakti se në kuadër të strukturës organizative të stacioneve policore nuk janë paraparë personel permanent i punësuar në organizatën e PK-së, mirëmbajtja e objekteve të stacioneve policore bëhet nga ana e kompanive të pastrimit të angazhuara me procedurat e tenderimit. Prej 40 stacioneve policore të inspektuara IPK-ja vlerëson se në 24 stacione policore apo 60% e tyre, niveli pastërtisë dhe kushteve higjienike vlerësohet si **i lartë**, me nivel shumë të mirë të pastërtisë. Në 10 stacione policore apo 25% e tyre, niveli pastërtisë dhe kushteve higjienike vlerësohet si **mesatar**, me nivel dhe kushte higjienike të kënaqshme më vend dhe mundësi për përmirësim. Kurse në 6 stacione policore apo 1,5% të këtyre stacioneve, niveli pastërtisë dhe kushteve higjienike vlerësohet si **i ulët**, me nivel dhe kushte higjienike jo të kënaqshme.

3.3.5 Gjendjen e katër stacioneve që vlerësohen me nivel të ulët të pastërtisë e pasqyron fakti se objektet policore të këtyre stacioneve janë tejet të vjetruara dhe të cilat objekte nuk i plotësojnë kushtet minimale për punë. Çështja e pastërtisë dhe higjienës si për objekte po ashtu edhe për vetura konsiston edhe me faktin se në shumicën e stacioneve policore në momentin e inspektimit kanë qenë të skaduar kontratat e mirëmbajtjes së pastërtisë.

Menaxherët e Stacioneve Policore kanë pohuar se përfundimi i kontratave për mirëmbajtje është një shqetësim që ndikon në kryerjen e detyrave policore.

Tabela nr. 8. Të dhënat e stacioneve policore lidhur me mirëmbajtjen higjienike dhe fizike-materiale të objekteve <sup>14</sup>		
Kriteri i vlerësimit		
I lartë (Niveli shumë i mirë i Mirëmbajtjes)	Mesatar (Nivel i kënaqshëm i pastërtisë)	I ulët (Niveli jo i kënaqshëm pastërtisë)
✓ Dragash	✓ Prishtinë Qendra	✓ Prishtinë Jugu
✓ Prizren	✓ Podujevë	✓ Prishtinë Veri
✓ Suharekë	✓ Obiliq	✓ Partesh
✓ Drenas	✓ Fushë Kosova	✓ Zubin Potok
✓ Graçanicë	✓ Gjilan	✓ Shtime
✓ Lipjan	✓ Viti	✓ Mamushë
✓ Ranilug	✓ Kaçanik	
✓ Klokot	✓ Novobërdë	
✓ Kamenicë	✓ Klinë	
✓ Mitrovicë Jugu	✓ Malishevë	
✓ Vushtrri		
✓ Skënderaj		
✓ Zveçan		
✓ Mitrovica Veri		
✓ Leposaviq		
✓ Ferizaj		
✓ Shtërpcë		
✓ Hani i Elezit		
✓ Pejë		
✓ Istog		
✓ Deçan		
✓ Junik		
✓ Gjakovë		
✓ Rahovec		

3.3.6 Gjatë inspektimit në këtë fushë në prezencë të menaxherëve, zyrtarëve kompetentë të stacioneve, IPK-ja ka kontrolluar fizikisht në total 93 automjete zyrtare policore. E interesuar për të konstatuar se a janë ato të pajisura me pajisjet dhe dokumentet e nevojshme konform parimit P-10.1.

3.3.7 Bazuar në Listën Kontrolluese të Pajisjeve për automjetet zyrtare policore, nga gjithsejtë 93 automjete, 64 automjete apo 69% prej tyre kanë qenë të pajisura me aparatën e radiolidhjes, 82 automjete apo 88% e tyre kanë qenë të pajisura me aparatën kundër zjarrit, 87 automjete apo 93.5 % e tyre kanë qenë të pajisura me pajisjet e ndihmës së parë, 91 automjete apo 98% e tyre kanë qenë të pajisura me gomën rezervë, si dhe 87 automjete apo 93.5% e tyre kanë qenë të pajisura me trekëndëshin e sigurisë.

3.3.8 Ndërsa bazuar në Listën Kontrolluese Dokumenteve, nga gjithsejtë 93 automjete, 75 apo 80.6% prej tyre, në listën e dokumenteve ishin prezent policat e sigurimit, 91 automjete apo 98% e tyre kishin formularin e mirëmbajtjes, 85 automjete apo 91% e tyre kanë qenë të pajisura me formularin e dëmtimeve të aksidentit, 92 automjete apo 99% e tyre kanë qenë të pajisura me formularin e udhëtimit (trip-tiketata), si dhe 90 automjete apo 96. % e tyre kanë qenë të pajisura me formularin raportit të drejtuesit mbi aksidentin.

3.3.9 Nëse merret për bazë gjendja e automjeteve sipas stacioneve policore të gjeturat e inspektimit tregojnë ekziston një gjendje përafërsisht e njëjtë e gjendjes së automjeteve dhe

<sup>14</sup> Të dhënat e siguruar gjatë inspektimit fizik të objekteve policore/Fotografitë nga tereni;

pajisjes me pajisjet dhe dokumentacionin relevant. Vlen të theksohet së nëpër stacione policore ka mungesë të konsiderueshme të veturave të cilat janë në gjendje të rregullt për qarkullim përkundër numrit të konsiderueshëm të veturave me të cilat janë të ngarkuar stacionet policore. Gjatë inspektimit është hasur në raste kur në stacione policore nuk ka pasur asnjë automjet në dispozicion për ta kontrolluar ekipi i inspektimit për shkak të mungesës së veturave, angazhimeve operative të njërive policore apo arsye të gjendjes së veturave në servisim (si rasti i stacionit policor Veri në Prishtinë, Junik, dhe Kamenicë).

3.3.10 Pasi dihet se automjetet policore bartin me vete kosto të lartë financiare duke u shpenzuar miliona euro për furnizimin dhe mirëmbajtjen e tyre, është e nevojshme që të ngritët në nivel të duhur përgjegjësia për t'u kujdesur për këtë pasuri. Në këtë drejtim, Doracaku 'Parimet dhe Procedurat e Policisë' në Parimin P-10.1 ka paraparë që Komandanti i stacionit është përgjegjës për kontrollimin e përhershëm, mundësinë e përdorimit dhe mirëmbajtjen e automjetit. Inspektorët policorë kanë kërkuar nga menaxherët e stacioneve të prezantojnë të dhëna që dëshmojnë se në kuadër të stacioneve janë kryer inspektime fizike të automjeteve. Inspektimi ka vënë në pah se gjatë vitit kalendarik 2015, nga 40 stacione policore të inspektuara 15 stacione apo 37.5% e tyre inspektimi i automjeteve zyrtare kryhet në periudha javore (inspektimi kryhet disa herë gjatë muajit), në 19 stacione apo 47.5%, inspektimi i automjeteve zyrtare kryhet në periudha mujore (inspektimi kryhet afërsisht një herë gjatë muajit) dhe në 6 stacione inspektimi kryhet në periudhë më rrallë së një muaj (inspektimi kryet ad-hok).

Tabela 9. Të dhënat mbi kryerjen e inspektimeve fizike të automjeteve <sup>15</sup>		
Kriteri i vlerësimit		
Në baza javore (inspektimi kryhet disa herë gjatë muajit)	Në baza mujore (kryhet mesatarisht një herë gjatë muajit)	Në periudhë më rrallë së një muaj (disa herë brenda vitit)
✓ Mitrovicë Veri	✓ Obiliq	✓ Shtërpçë
✓ Leposaviq	✓ Graçanicë	✓ Junik
✓ Vushtrri	✓ Suharekë	✓ Hani i Elezit
✓ Prishtinë Jug	✓ Dragash	✓ Pejë
✓ Prishtinë Qendra	✓ Malishevë	✓ Kamenicë
✓ Prishtinë Veri	✓ Zveçan	✓ Mamushë
✓ Podujevë	✓ Zubin Potoku	
✓ Lipjan	✓ Mitrovicë Jug	
✓ Fushë Kosova	✓ Skenderaj	
✓ Drenas	✓ Ferizaj	
✓ Gjilan	✓ Viti	
✓ Prizren	✓ Shtime	
✓ Partesh	✓ Novobërdë	
✓ Ranilug	✓ Istog	
✓ Kllokot	✓ Deçan	
	✓ Klinë	
	✓ Rahovec	
	✓ Gjakovë	
	✓ Kaçanik	

3.3.11 Sipas Parimit P-3.60 (Ruajtja e armëve të PK-së) parashihet që çdo polic që udhëton jashtë Kosovës për pushim (vjetor, mjekësor etj apo për trajnim përmes shërbimit, është i obligueshëm që ta dorëzoj armën e tij për ruajtje në zyrën mbështetëse administrative në kuadër të Stacionit të PK-së. Përveç kësaj, nëse ndonjë polic i PK-së mendon se ka nevojë për të bërë një sigurim shtesë të armës në stacion e tij/saj, apo për arsye se ka fëmijë të vegjël në shtëpi, atëherë një gjë e tillë lejohet në bazë të lejes me shkrim nga Komandanti i stacionit. Me këtë rast duhet praktikuar përdorimin e arkave apo sirtarëve të sigurt për ruajtjen e tyre.

<sup>15</sup> Të dhënat e siguruar gjatë inspektimit, mostrat e raporteve të inspektimit;

Lidhur me ruajtjen e armëve të zjarrit për situatat që parashihen me Doracakun “Parimet dhe Procedurat e Policisë”, IPK-ja nuk ka vërejtur se me ndonjë dokument zyrtar është paraparë përdorimi i ndonjë inventari standard që do të shërbente si model unik për të gjitha stacionet. IPK-ja vlerëson se për të mos u krijuar laramani në kuadër të stacioneve për formën dhe materialin e inventarit për ruajtjen e armëve të zjarrit, duhet të shqyrtohet mundësia që një gjë e tillë të rregullohet me parim të veçantë. Kjo do të ofronte bazë të duhur për të ngritur nivelin e sigurisë në kuadër të stacioneve, duke pamundësuar çdo formë të humbjes, shmangies apo keqpërdorimit të armëve.

3.3.12 Për t’u siguruar se ekzistojnë vendet e sigurta për ruajtjen e armëve në kuadër të stacioneve dhe për të vlerësuar nivelin e sigurisë së tyre, IPK-ja ka inspektuar hapësirat në kuadër të stacioneve dhe ka vërejtur se për ruajtjen e armëve të zjarrit në 40 stacione përdoret inventar i përshtatshëm për ruajtje të armëve. Mirëpo nëpër stacione policore nuk aplikohet standardi unik i vend ndodhjes së sirtarëve për ruajtjen e armëve, në disa stacione ato gjenden nëpër zyrat e komandantëve të stacioneve, në disa tjerë nëpër zyrat e administratës.

3.3.13 Në drejtim të ngritjes së sigurisë së zyrtarëve policorë në punë, në periudha të caktuara kohore mbikëqyrësit kontrollojnë armët e tyre zyrtare. Kjo nënkupton se është e nevojshme që në kuadër të çdo stacioni të kryhet inspektimi i rregullt fizik i armëve të zjarrit. Për të kryer këtë procedurë kontrolli, në kuadër të stacioneve parashihet ndarja dhe improvizimi i një hapësire të veçantë e cila do të shërbente për kontrollimin/zbrazjen e armës së zjarrit. IPK-ja ka kontrolluar këto hapësira të dedikuara për kontroll/zbrazje të armës dhe ka vërejtur në shumicën e stacioneve ekzistojnë hapësira por janë të pa shfrytëzuara dhe të pa mirëmbajtura që nënkupton se zbrazja dhe kontrolli i armeve bëhet në mënyrë të pa sigurt.

3.3.14 Në drejtim të ngritjes së efikasitetit për të siguruar të dhëna të vazhdueshme për nivelin e mbikëqyrjes së armëve, IPK-ja ka vërejtur se në kuadër të stacioneve që një kohë ka filluar përdorimi i formularëve standard të kontrollimit të armëve. IPK-ja ishte e interesuar të kontrollojë një numër formularësh për të vlerësuar se inspektimi fizik i armëve bëhet rregullisht. IPK-ja ka siguruar formularët e inspektimit të armëve dhe ka vërejtur se në kuadër të 40 stacioneve ekzistojnë dëshmitë (formularët) por kjo formë e inspektimit nuk është unike në gjitha stacionet policore, inspektimi fizik i armëve të zjarrit kryhet rregullisht në baza mujore. Në 17 stacionet policor kryet inspektimit armëve, municioneve dhe kallfëve, në 23 stacionet policor përveç këtyre tri artikujve, kryhet edhe inspektimi i prangave, shufrës, sprejit, dhe uniformes. IPK-ja inkurajon menaxhmentet policore të këtyre stacioneve që të vazhdohet me përkushtimin dhe seriozitetin në funksionalizimin e inspektimeve të rregullta, hapësirat e dedikuara për zbrazje të sigurt të armeve të funksionalizohen duke kontribuar në ngritjen e masave të sigurisë.

3.3.15 Në luftën kundër krimit, shpeshherë policia arrin të konfiskojë në vendngjarje numër të konsiderueshëm të gjërave, të cilat më pas për nevoja të seancave gjyqësore shërbejnë si dëshmi të krimit. Prej momentit të konfiskimit të tyre e deri në momentin kur ato kalojnë procedurat e nevojshme hetimore dhe gjyqësore, ato duhet të qëndrojnë në vende të sigurta. Stacionet policore për këtë qëllim kanë përgatitur hapësira të veçanta të cilat sipas procedurave standarde në fuqi duhet t’i plotësojnë disa kritere (kushte) bazë. Inspektimet e kaluara kanë vënë në pah një përkushtim jo të duhur të menaxhmenteve policore në sigurimin e kushteve të nevojshme në dhomat e dëshmive. Kushtet e nevojshme që duhet t’i plotësojnë dhomat e dëshmive janë paraparë me ‘Procedura Standarde të Operimit për Dhomat e Dëshmive’.

3.3.16 IPK-ja gjatë inspektimit të kryer në stacionet policore është shërbyer me Listën Kontrolluese të kriterëve që duhet të plotësojnë dhomat e tilla. Lista Kontrolluese është përbërë prej dhjetë (10) kriterëve bazë të përzgjedhura nga PSO-të që përmban kushtet që duhet të plotësojnë dhomat e dëshmimeve (hapësira e mjaftueshme, alarmi i instaluar, ventilimi i duhur, pajisja me frigorifer, dyert e sigurta, pajisja me raftë për vendosjen e dëshmimeve, mos prezenca e lagështisë, instalimi i detektorit të tymit, prezenca e aparatit për shuarjen e zjarrit dhe pajisja me lavaman për larjen e duarve).

3.3.17 Duke përmbajtur kriteret bazë për dhomat e dëshmimeve, Lista Kontrolluese është verifikuar në kuadër të çdo stacioni në prezencën e mbikëqyrësve. Marrë parasysh kriteret që kërkohen për të plotësuar standardet e kërkuara me rregullat në fuqi, IPK-ja ka konstatuar se prej 40 stacioneve policore të inspektuara në 27 stacione policore është bërë inspektimi i dhomave të dëshmimeve për të parë kushtet e përgjithshme të dhomave dhe nivelin e sigurisë së tyre. Në 15 stacione policore apo 55.5% e tyre, plotësojnë pjesën dërmuese të standardeve të kërkuara. Në 9 stacione policore apo 33.5% e tyre, kushtet në dhomat e dëshmimeve plotësojnë disa nga standardet e kërkuara. Kurse në 3 stacione policore apo 11% të tyre, kushtet në dhomat e dëshmimeve plotësojnë minimalisht standardet e kërkuara.

Tabela nr. 10. Të dhënat mbi kushtet në dhomat e dëshmimeve në kuadër të stacioneve policore <sup>16</sup>		
Kriteri i vlerësimit		
Deri në 8 nga 10 kriterë (kushtet në dhomat e dëshmimeve plotësojnë pjesën dërmuese të standardeve të kërkuara)	5-7 nga 10 kriterë (kushtet në dhomat e dëshmimeve plotësojnë disa nga standardet e kërkuara)	Deri në 4 nga 10 kriterë (kushtet në dhomat e dëshmimeve plotësojnë minimalisht standardet e kërkuara)
<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Lipjan</li> <li>✓ Drenas</li> <li>✓ Vushtrri</li> <li>✓ Zubin Potok</li> <li>✓ Zveçan</li> <li>✓ Pejë</li> <li>✓ Istog</li> <li>✓ Klinë</li> <li>✓ Deçan</li> <li>✓ Prizren</li> <li>✓ Suharekë</li> <li>✓ Kamenicë</li> <li>✓ Viti</li> <li>✓ Gjakovë</li> <li>✓ Malishevë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Mitrovicë Jugu</li> <li>✓ Mitrovicë Veri</li> <li>✓ Skenderaj</li> <li>✓ Dragash</li> <li>✓ Ferizaj</li> <li>✓ Shtime</li> <li>✓ Gjilan</li> <li>✓ Novobërdë</li> <li>✓ Rahovec</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Prishtinë Jugu</li> <li>✓ Prishtinë Veri</li> <li>✓ Shtërpçë</li> </ul>

3.3.18 Menaxhimi i pasurive parasheh edhe regjistrimin e pasurive të organizatës e cila është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ nr. 21/2009, me të cilin rregullohet menaxhimi efektiv i pasurive. Kjo ka të bëjë me evidentimin e pasurisë që kanë në shfrytëzim stacionet policore, si dhe përgjegjësinë që ka personeli i stacionit për t'u kujdesur për evidencën e pasurive. IPK-ja ka kërkuar nga stacionet evidencën mbi pasuritë dhe pas inspektimit ka konstatuar se në kuadër të 40 stacioneve policore të inspektuara mbahet evidence dhe regjistrimi (inventarizimi) i pasurive, të cilat janë dëshmuar me regjistrin e pasurive. Mirëpo inspektorët e IPK-së, në bazë të dokumenteve të rishikuar kanë gjetur së vetëm në 11 stacionet policore është formuar komisioni për regjistrimin e pasurisë, me vendim të komandantit të stacionit, i cili kryhet për ç' do vit kalendarik, ndërsa në stacionet tjera bëhet

<sup>16</sup> Të dhënat e mbledhura nga stacionet policore gjatë inspektimit/Përgjigje në formularin e detyrave nga IPK-ja;

inspektimi nga ana zyrtarëve të Drejtorisë së Logjistikës, por inspektorët nuk kanë pas ndonjë dokument se ata zyrtarë janë caktuar për të kryer inventarizimin.

<b>Tabela nr. 11. Inventarizimi pasurisë së stacioneve policore</b>	
Stacionet që kanë bërë vetëm regjistrin e pasurive	Stacionet që kanë kryer regjistrin e pasurive dhe inventarizimin me komision të formuar
<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Mitrovicë Veri</li> <li>✓ Leposaviq</li> <li>✓ Vushtrri</li> <li>✓ Prishtinë Jugu</li> <li>✓ Prishtinë Veri</li> <li>✓ Podujevë</li> <li>✓ Lipjan</li> <li>✓ Fushë</li> <li>✓ Kosova</li> <li>✓ Drenas</li> <li>✓ Gjilan,</li> <li>✓ Partesh</li> <li>✓ Klokot</li> <li>✓ Obiliq</li> <li>✓ Shtime,</li> <li>✓ Suharekë</li> <li>✓ Dragash</li> <li>✓ Zveçan</li> <li>✓ Zubin Potoku</li> <li>✓ Mitrovicë Jugu</li> <li>✓ Skenderaj</li> <li>✓ Shtime</li> <li>✓ Novobërdë</li> <li>✓ Istog</li> <li>✓ Deçan</li> <li>✓ Rahovec</li> <li>✓ Shtërpçë</li> <li>✓ Junik</li> <li>✓ Hani i Elezit</li> <li>✓ Pejë</li> <li>✓ Mamushë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Klinë</li> <li>✓ Prishtinë Qendra</li> <li>✓ Prizren</li> <li>✓ Gjakovë</li> <li>✓ Kaçanik</li> <li>✓ Ranilug</li> <li>✓ Kamenicë</li> <li>✓ Graçanicë</li> <li>✓ Malishevë</li> <li>✓ Ferizaj</li> <li>✓ Viti</li> </ul>

## 4. PËRFUNDIMET

---

4.1 Stacionet policore gjatë punës dhe aktiviteteve policore brenda një viti, iniciojnë një numër të konsiderueshëm të rasteve për trajtim. Gjatë vitit 2015, nga gjithsejtë 40 stacionet policore të inspektuara, gjatë vitit 2015 në kuadër të këtyre stacioneve, janë iniciuar gjithsejtë 38.846 raste, që në raport me numrin e përgjithshëm të zyrtarëve policor të angazhuar (3.298 zyrtarë policorë të uniformuar) në këto stacione policore del mesatarisht 12 raste për një (1) zyrtar policor. Stacionet policore, varësisht nga faktorët dhe veçoritë e tyre, disa stacione policore janë të njohura për numrin më të madh të rasteve të iniciuara ndërsa disa stacione policore kanë nivel dukshëm më të ulët të rasteve të iniciuara për përudhen e vitit kalendarik 2015.

4.2 Stacionet policore gjatë një viti kalendarik pranojnë numër të konsiderueshëm të urdhëresave të gjykatës për ekzekutim. Numrin e urdhëresave për një vit, përfshijnë urdhëresat e pranuar brenda viti kalendarik, përfshirë edhe numrin e urdhëresave të bartura nga viti paraprak. Gjatë vitit 2015, në 40 stacione policore janë evidentuar gjithsejtë 163.208 urdhëresa. Marrë parasysh mesataren e përgjithshme të urdhëresave të pranuar në nivel stacionesh që sillet rreth 50 urdhëresa për polic në nivel vendi. Disa stacione policore varësisht nga veçoritë e tyre kryesisht stacionet e kategorisë A, kanë numër më të lartë të urdhëresave të pranuar për vitin 2015. Ndërsa sa i përket nivelit të zbatimit gjatë vitit 2015, zyrtarët policorë të stacioneve nga gjithsejtë 163.208 urdhëresa, brenda vitit 2015, kanë realizuar 62.060 urdhëresa apo 38 % të tyre. Me shumë se 62% e urdhëresave të pranuar në mungesë të realizimit të tyre barten për vitin vijues. Numër konsiderueshëm i urdhëresave të gjykatave vjetërsohen dhe lëndët e tyre parashkruhen në bazë të afateve ligjore për parashkrim. Mirëpo referuar intervistave dhe takimeve me menaxhmentin lokal dhe rajonal, aktivitetet policore kanë prioritet zbatimin e urdhëresave për lëndët penale të cilat zakonisht realizohen.

4.3. Procedura e raportimit për ekipet patrulluese, si dhe e ndërrimeve të stacioneve policore, çoftë gjatë orarit apo edhe pas përfundimit, ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave dhe përcjelljen/dorëzimin e gjendjes për ndërrimin pasues. Njësitë patrulluese të ndërrimeve kujdestare, kryejnë raportimin e rregullt në përfundim të orarit të rregullt të punës.

4.4 Në dyzet (40) stacione policore në kuadër të detyrave policore, janë të angazhuar gjithsejtë 3.298 zyrtarë policorë të uniformuar. Në aspektin demografik, duke vënë në raport numrin e zyrtarëve policorë të stacioneve me numrin e banorëve nëpër territoret e kontrolluar, për 1,739,825 banorë<sup>17</sup> sa ka Kosova, del se stacionet policore kanë të angazhuar afërsisht mesatarisht një (1) polic për 528 banorë, kurse në aspektin gjeografik-territorial, nga gjithsejtë sa ka Kosova i bie afërsisht 3.1 km<sup>2</sup> hapësirë territoriale mbulohet nga 1 policë. Në kontestin e prezantimit të stacioneve policore veç e veç të dhënat lidhur me shpërndarjen e stafit policor në raport me faktorët e gjeografik dhe demografik të zonës së përgjegjësisë së stacioneve, tregojnë se ka dallime të konsiderueshme nga stacioni në stacion.

4.5 Sa i përket përfshirjes së vijueshmërisë së zyrtarëve policore në programin e trajnimeve të brendshme brenda DRP-ve, mbi 2/3 e stacioneve policore gjatë vitit 2015, kanë arrit të realizojnë me mbi 85% të vijueshmërisë së zyrtarëve policor në trajnimet brenda regjionit. Ndërsa afër 1/3 e stacioneve policore gjatë vitit 2015, ka arritur të realizoj nën 86% sa i përket orëve të trajnimit të vijueshmërisë së zyrtarëve policor brenda regjionit.

---

<sup>17</sup> Agjencioni i Statistikave të Kosovës/Regjistrimi i popullsisë së vitit 2011;



4.6 Në kuadër të stacioneve policore, trajnimi i ricertifikimit për periudhën 2015, nga 3009 zyrtarë policor të planifikuar për vijimin e trajnimit të ricertifikimit për armë zjarri, trajnimin e kanë kryer 1.625 zyrtarë policorë (54%). Ndërsa mbi 46% e zyrtarëve policorë të stacioneve, gjatë vitit 2015, nuk kanë vijuar trajnimin e ricertifikimit.

4.7 Në kuadër të strukturës organizative të stacioneve policore nuk janë paraparë personel permanent për mirëmbajtjen e objekteve të stacioneve policore i punësuar në PK-së, mirëmbajtja e objekteve të stacioneve policore behet nga ana e kompanive të pastrimit të angazhuara me proceduarat e tenderimit. Në pjesën më të madhe të stacioneve policore të inspektuara IPK-ja ka vlerësuar së niveli pastërtisë dhe kushteve higjienike vlerësohet e mirë. Të një numër i vogël i stacioneve pastërtisë dhe kushteve higjienike vlerësohet si jo i mirë, me nivel dhe kushte higjienike jo të kënaqshme. Gjendjen e këtyre stacioneve policore e pasqyron fakti së objektet policore të këtyre stacioneve janë tejet të vjetruara, jo adekuate siç është rasti me kontejner, të cilat nuk i plotësojnë kushtet minimale për punë.

4.8 Objektet e stacioneve policore janë të pajisura me aparate të mjaftueshme për fikjen zjarrit, pajisje të cilat janë kontrolluar e testeve të tyre nga ana e Agjencionit për Menaxhimin e Emergjencave. Nëpër hapësirat e objekteve të stacioneve policore janë të vendosura pajisjet e detektimit të tymit, por nuk është arritur të konfirmojmë nga menaxhmenti apo personeli kompetent, së këto pajisje janë testuar ndonjëherë për gjendjen teknike gjatë vitit 2015.

4.9 Gjatë kontrollit fizik të gjithsejtë 93 automjete zyrtare policore, diku mbi 80% e këtyre automjeteve ishin të pajisura me artikujt (pajisjet e nevojshme) të Listës Kontrolluese të Pajisjeve për automjetet zyrtare policore, kurse diku nën 20% e automjeteve policore nuk kanë qenë të kompletuara me pajisjet e nevojshme të kërkuara sipas listës kontrolluese. Ndërsa mbi 85 % e automjeteve të inspektuara, kanë qenë të kompletuara me dokumentet e nevojshme sipas listës kontrolluese të dokumenteve të veturave zyrtare. Gjendja e veturave sipas stacioneve policore të gjeturat e inspektimit tregojnë së ekziston një gjendje përafërsisht e njëjtë e gjendjes së automjeteve dhe pajisjes me pajisjet dhe dokumentacionin relevant. Nëpër stacione policore ka mungesë të konsiderueshme të veturave të cilat janë në gjendje të rregullt për qarkullim përkundër numrit të konsiderueshëm të veturave me të cilat janë të ngarkuar stacionet policore.

4.10 Ruajtja e armëve të PK-së parashihet që ' çdo polic që udhëton jashtë Kosovës për pushim vjetor, mjekësor etj apo për trajnim përmes shërbimit, është i obligueshëm që ta dorëzoj armën e tij për ruajtje në zyrën mbështetëse administrative në kuadër të Stacionit të PK-së Për t'u siguruar se ekzistojnë vendet e sigurta për ruajtjen e armëve në kuadër të stacioneve dhe për të vlerësuar nivelin e sigurisë së tyre, në kuadër të stacioneve policore përdoret inventar i përshtatshëm për ruajtje të armëve. Mirëpo nëpër stacione policore nuk aplikohet standardi unik i vendosjen apo menaxhimit në kuadër të përgjegjësisë menaxheriale të sirtarëve për ruajtjen e armëve, në disa stacione ato gjenden apo menaxhohen nën kujdesin e komandantëve të stacioneve, në disa tjerë nëpër zyrat (përgjegjësit) e administratës së stacioneve.

4.11 Në drejtim të ngritjes së efikasitetit për të siguruar të dhëna të vazhdueshme për nivelin e mbikëqyrjes së armëve, IPK-ja ka vërejtur se në kuadër të stacioneve që një kohë ka filluar përdorimi i formularëve standard të kontrollimit të armëve. Tek formularët e inspektimit të armëve, është vërejtur se në kuadër të 40 stacioneve nuk aplikohen formularët standarde në të gjitha stacionet policore. Pastaj është konstatuar së inspektimi fizik i armëve zyrtare kryhet në baza mujore apo në disa stacione më rrallë (disa herë brenda vitit). Në 17

stacionet policor kryet inspektimi i armëve, municioneve dhe këllëfëve, në 23 stacionet policor përveç këtyre tri artikujve, kryhet edhe inspektimi i prangave, shufrës, sprejit OC, dhe uniformes.

4.12 Provat dhe dëshmitë të cilat policia arrin të konfiskojë në vendngjarje, të cilat më pas për nevoja të procedurës hetimore dhe gjyqësore, ato duhet të qëndrojnë në vende të sigurta. Stacionet policore për këtë qëllim kanë përgatitur hapësira të veçanta të cilat sipas procedurave standarde në fuqi duhet t'i plotësojnë disa kritere (kushte) bazë. Për ndryshme nga vitet e kaluara, nga menaxhmenti policorë i PK-së si atyre të stacioneve është vërejtur së iu është kushtuar kujdes përmirësimit të kushteve dhe sigurisë për dhomat e dëshmive në stacioneve policore. Marrë parasysh kriteret që kërkohen për të plotësuar standardet e kërkuara me rregullat në fuqi, pjesa dërmuese e stacioneve policore, plotësojnë pjesën dërmuese të standardeve të kërkuara. Në 9 stacione policore apo 33.5% e tyre, kushtet në dhomat e dëshmive plotësojnë disa nga standardet e kërkuara. Kurse në 3 stacione policore apo 11% të tyre, kushtet në dhomat e dëshmive plotësojnë minimalisht standardet e kërkuara.

4.13 Udhëzimin Administrativ nr. 21/2009, rregullohen menaxhimin efektiv të pasurive i cili parasheh Menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive të organizatës. Kështu që evidentimin e pasurisë që kanë në shfrytëzim stacionet policore, si dhe përgjegjësinë që ka personeli i stacionit për t'u kujdesur për evidencën e pasurive e parasheh udhëzimi i cekur më lartë. Gjatë vitit 2015, në kuadër të 40 stacioneve policore të inspektuara është mbajtur evidencë dhe regjistrimi (inventarizimi) i pasurive, të cilat janë dëshmuar me regjistrin e pasurive. Mirëpo vetëm në 11 stacionet policore është prezantuar dokumentacion që është formuar komisioni për regjistrimin e pasurisë, (inventarizim) me vendim të komandantit të stacionit, i cili kryet për ç' do vit kalendarik.

## 5. REKOMANDIMET

---

Në drejtim të përmirësimit dhe ngritjes së vazhdueshme të performancës së personelit policor, IPK-ja nxjerrë për PK-në këto rekomandime kryesore:

1. *IPK-ja rekomandon menaxhmentin e stacioneve policore të PK-së të cilat kanë përfshirje nën 85% të vijueshmërisë së zyrtarëve policor në trajnimet brenda regjionit, të bëjë përpjekje maksimale për respektimin e Parimit P-8.15, drejtë ngritjes së shkallës vijueshmërisë së personelit në trajnimet e brendshme brenda Regjionit.*
2. *IPK-ja rekomandon menaxhmentin e stacioneve policore të ndërmarrë masat e nevojshme për respektimin e Parimit P-8.14, drejt ngritjes së nivelit të vijueshmërisë apo përfshirjes së gjithë personelit policor në trajnimin e ricertifikimit brenda vitit kalendarik.*
3. *IPK-ja rekomandon Drejtorinë e Përgjithshme të PK-së/Drejtorinë për menaxhimin e Objekteve të PPK-së, të aplikojë praktikën e testimit të pajisjeve alarmeve (detektorëve të tymit dhe alarmeve të sigurisë) për objektet e stacioneve policore të paktën një herë brenda një viti kalendarik.*
4. *IPK-ja rekomandon menaxhmentin e stacioneve policore të PK-së, që të bëjë përpjekje maksimale drejtë ngritjes së shkallës të realizueshmërisë së urdhëresave të gjykatës brenda një viti kalendarik.*
5. *IPK-ja rekomandon Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse të PK-se që sa më shpejt të siguroj kontrata lidhur me mirëmbajtje/pastrimin e objekteve dhe veturave zyrtare policore.*
6. *IPK-ja rekomandon menaxhmentin e stacioneve policore të ndërmarrë masat e nevojshme për respektimin e Parimit P-10.1, për kompletimin e veturave policore me pajisjet e nevojshme sipas listës kontrolluese si dhe kompletimin e listës së dokumentacionit relevant nëpër veturat zyrtare policore.*
7. *IPK-ja rekomandon menaxhmentin e stacioneve policore që sa i përket vendosjes dhe ruajtjes të armëve zyrtare të standardizojnë çështjen e inventarit për ruajtjen e armëve të zjarrit me qëllim të respektimit të Parimit P-3.60, për standardet e ruajtjes së armëve zyrtare.*
8. *IPK-ja rekomandon menaxhmentin e stacioneve policore (stacionet të cilat nuk aplikojnë formularët standardë) që gjatë procesit të inspektimit të armëve zyrtare të aplikohen formular standardë për inspektimin e armëve zyrtare.*
9. *IPK-ja rekomandon Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë që të ndërmarr hapat e nevojshme për përmirësimin dhe kompletimin e kushteve nëpër hapësirat e dhomave të dëshmitave të stacioneve policore.*
10. *IPK-ja rekomandon menaxhmentin e stacioneve policore që brenda çdo viti kalendarik, të formojë komision për inventarizimin e pasurive në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 21/2009Për menaxhimin e pasurisë Qeveritare.*

## 6. PLANI I VEPRIMIT PËR PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE

Nr	Rekomandimi	Prioriteti	Komentet	Plani Veprimit
1.	IPK-ja rekomandon menaxhmentin e stacioneve policore të PK-së të cilat kanë përfshirje nën 85% të vijueshmërisë së zyrtarëve policor në trajnimet brenda regjionit, të bëjë përpjekje maksimale për respektimin e Parimit P-8.15, drejtë ngritjes së shkallës vijueshmërisë së personelit në trajnimet e brendshme brenda Regjionit.	I lartë	<b><u>Pajtohemi</u></b>	K-4
2.	IPK-ja rekomandon menaxhmentin e stacioneve policore të ndërmarrë masat e nevojshme për respektimin e Parimit P-8.14, drejtë ngritjes së nivelit të vijueshmërisë apo përfshirjes së gjithë personelit policor në trajnimin e ricertifikimit brenda vitit kalendarik.	I lartë	<b><u>Pajtohemi</u></b> Si rezultat I çështjeve financiare/buxhetore si dhe vështirësive në furnizim me municion, ka munguar ri-certifikimi. Për PK është me prioritet që të kryhet trajnimi I ricertifikimit sipas parimit në fuqi.	K-4 K-1 2017
3.	IPK-ja rekomandon Drejtorinë e Përgjithshme të PK-së/Drejtorinë për menaxhimin e Objekteve të PPK-së, të aplikojë praktikën e testimit të pajisjeve alarmeve (detektorëve të tymit dhe alarmeve të sigurisë) për objektet e stacioneve policore të paktën një herë brenda një viti kalendarik.	I lartë	DMO-ja ka ngritur kërkesën për lidhjen e kontratës dy vjeçare për instalimin e alarmeve kundër zjarrit dhe alarmeve kundër thyerjes në objektet ku nuk janë të instaluar këto sisteme. Në ndërkohe është duke bere përgatitjen e specifikave për lidhjen e kontratës dy vjeçare për mirëmbajtjen periodike dhe servisimin e sistemeve të alarmeve në objektet në të cilat janë të instaluar sistemet e alarmeve kundër zjarrit dhe alarmeve kundër thyerjes	K1 (2017)
4.	IPK-ja rekomandon menaxhmentin e stacioneve policore të PK-së, që të bëjë përpjekje maksimale drejtë ngritjes së shkallës të realizueshmërisë së urdhëresave të gjykatës brenda një viti kalendarik.	I lartë	<b><u>Pajtohemi</u></b>	K-4
5.	IPK-ja rekomandon Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse të PK-se që sa më shpejt të siguroj kontrata lidhur me mirëmbajtje/pastrimin e objekteve dhe veturave zyrtare policore.		<b>1. Kontrata për mirëmbajtje të objekteve të PK-se</b> Jemi në pritje të lidhjes së kontratës për shërbime pastrimi për të gjitha objektet e PK-se ku nuk ka të punësuar zyrtarë të PK-se, bazuar në njoftimin AQP-se që të gjitha aktivitetet e Prokurimit ndërmerren nga AQP-ja  <b>Pastrimi i veturave</b> Janë lidhur kontratat gjitha Regjionet e PK-se	K4 (2016) K3 (2016)
6.	IPK-ja rekomandon menaxhmentin e stacioneve policore të ndërmarrë masat e nevojshme për respektimin e Parimit P-10.1, për kompletimin e veturave policore me pajisjet e nevojshme sipas listës kontrolluese si dhe kompletimin e listës së dokumentacionit relevant nëpër veturat zyrtare policore.	I lartë	<b><u>E gjetura qëndron.</u></b> Nga Drejtori i DSHM-së është kërkuar raportim në baza javore nga të gjithë zyrtarët përgjegjës për automjetet e PK-se rreth përshkrimit të gjendjes teknike të automjeteve dhe pajisjeve të cilat i posedojnë Në nivel të Sektorit të Flotës Operative është formuar ekipi për inspektimin e të gjitha automjeteve të PK-së të cilët do të identifikojnë mungesën e pajisjeve dhe dokumentacionit të nevojshëm komfor Ligjit në fuqi	Pas identifikimit të pajisjeve që mungojnë do të bëhet furnizimi me ato pajisje të cilat i posedojmë në stok ndërsa për ato pajisje që nuk posedojmë kontratë valide do të planifikohen për inicim. Periudha e implementimit do të jete K4 2017-të ( varësisht nga procedurat e Prokurimit dhe buxheti në dispozicion)
7.	IPK-ja rekomandon menaxhmentin e	I	Drejtoria për logjistike ka iniciuar projektin	Projekti pritet të

	stacioneve policore që sa i përket vendosjes dhe ruajtjes të armëve zyrtare të standardizojnë çështjen e inventarit për ruajtjen e armëve të zjarrit me qëllim të respektimit të Parimit P-3.60, për standardet e ruajtjes së armëve zyrtare.	I lartë	për sigurimin e kasafortave për ruajtjen e armëve zyrtare ne ambientet e banimit për te gjithë zyrtaret policor	realizohet ne tërësi ne periudhën 2016-2019. (varësisht nga procedurat e Prokurimit dhe buxheti ne dispozicion)
8.	IPK-ja rekomandon menaxhmentin e stacioneve policore (stacionet të cilat nuk aplikojnë formularët standardë) që gjatë procesit të inspektimit të armëve zyrtare të aplikohen formular standardë për inspektimin e armëve zyrtare.	I lartë	<b><u>Pajtohemi</u></b>	Tetor 2016
9.	IPK-ja rekomandon Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë që të ndërmarr hapat e nevojshme për përmirësimin dhe kompletimin e kushteve nëpër hapësirat e dhomave të dëshmive të stacioneve policore.	I lartë	<b><u>Pajtohemi</u></b> DMO-ja ka ngritur kërkesën për lidhjen e kontratës për instalimin e alarmeve kundër zjarrit dhe alarmeve kundër thyerjes ne te gjitha hapësirat ku ka nevoje per këto sisteme si dhe është duke bere përgatitjen e specifikave për lidhjen e kontratës dy vjeçare për mirëmbajtjen periodike dhe seroisimin e sistemeve te alarmeve ne te gjitha hapësirat ku kërkohet siguria e hapësirave.	K4 2016
10.	IPK-ja rekomandon menaxhmentin e stacioneve policore që brenda çdo viti kalendarik, të formojë komision për inventarizimin e pasurive në përputhje më Udhëzimin Administrativ nr. 21/2009Për menaxhimin e pasurisë Qeveritare.	I lartë	Drejtori i Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse me vendim cakton komisionin për inventarizim gjithëpërfshirës për Policinë e Kosovës. Ky komision caktohet njëherë në vit. Me qëllim të kryerjes më të shpejtë të inventarizimit tani përdoret praktika e komisionit me shumë ekipe (secila Drejtori Rajonale Policore dhe Kufitare dhe DPP nga një ekip) të cilët kryejnë inventarizimin për rajonin e vet të përgjegjësish dhe ekipi i DPP nga të gjitha raportet përpilon atë gjithëpërfshirës. Praktika e shfrytëzimit te komisionit për inventarizim me shume ekipe të shpërndara në tërë vendin mundëson që në të ardhmen te mos ketë vonesa ne inventarizim, duke mundësuar qe inventarizimi te jete me i shpejt dhe me i sakte.	K-4